



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2816 Prot.

Lezhë, më 3 . 3 , 2022

VENDIM

Nr. 22 Datë 28 . 02 .2022

Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

1. Miratimin e një shtese në buxhetin e bashkisë për vitin 2022, si më poshtë:

1/1-Të shtohen burimet në buxhetin e vitit 2022 në shumën 451,420 lekë, donacion nga World Vision.

2/2-Të shtohen shpenzimet në programin buxhetor si më poshtë:

- Gr.00, Prog.10430, Kap.05, Art.600 për shumën 386,821 lekë dhe Art.601 për shumën 64,599 lekë. Këto shpenzime do të bëhen për 5 punonjësit e projektit “Tungjatjeta Jetë”.

2. Miratimin e ndryshimit të buxhetit në programin buxhetor 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”.

- Pakësohet : Gr.00, Prog.10430, Kap.05, Art.602 për shumën 365,000 lekë, me emërtim “Mbësh-tetje psiko-sociale dhe ekonomike për rastet e menaxhuara”.

- Shtohet : Gr.00, Prog.10430, Kap.05, Art.600 për shumën 312,768 lekë dhe Gr.00, Prog.10430, Kap.05, Art.601 për shumën 52,232 lekë

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ